



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurave **Fatjona Begolli**, e akuzuar për veprën penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i katërt i K.Penal dhe **Lefteria Bushi**, e akuzuar për veprën penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i dytë i K.Penal”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Elsa Ulliri, Flora Hajredinaj dhe Bib Ndreca, me vendimin Nr. **3**, datë **09.01.2025** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtores të të pandehurës **Fatjona Begolli** për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i katërt i K.Penal dhe dënimin e saj me 3 vite burgim.
- 2.** Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës **Fatjona Begolli** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 vite burgim.
- 3.** Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi, duke e vënë në provë të pandehurën, për një periudhë kohe prej 4 vitesh me kusht që gjatë kësaj kohe, i pandehuri të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.
- 4.** Në aplikim të nenit 35/1 të K.Penal të pandehurës **Fatjona Begolli** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vitesh.
- 5.** Deklarimin fajtores të të pandehurës **Lefteria Bushi** për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i dytë i K.Penal dhe dënimin e saj me 1 vit burgim.
- 6.** Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës **Lefteria Bushi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim.
- 7.** Në aplikim të nenit 52/a të K.Penal përjashtimin e të pandehurës **Lefteria Bushi** nga vuajtja e dënimit.

8. Provat materiale që i janë bashkëlidhur fashikullit të gjykimit, konkretisht USB, me ngjyrë të zezë, me mbishkrimin 32Gb, e dorëzuar nga shtetasja D.Sh sipas procesverbalit të datës 29.10.2024; USB, me ngjyrë gri, me mbishkrimin Media Range 16 Gb, e dorëzuar nga shtetasja Lefteria Bushi sipas procesverbalit të datës 11.09.2024; USB Verbatim 256 Gb, me ngjyrë të zezë, që përmban të dhënat që janë përfituar nga akti i ekspertimit teknik-kompjuterik Nr.114, datë 07.06.2024, në lidhje me telefonin e sekuestruar të pandehurës Fatjona Begolli; Cd-ja që përmban të dhënat e përcjella nga “AK Invest”, administruar me shkresën me Nr.Prot.110, datë 23.01.2024; Cd-ja që përmban tabulatet telefonike të numrave të telefonit që janë vënë në dispozicion nga shoqëria “One”, me shkresën me Nr.Prot.1475/1, datë 17.04.2024, të mbeten pjesë e fashikullit.
9. Shpenzimet proceduriale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurave në mënyrë solidare.
10. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

Tiranë, më datë 09.01.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar